



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 29.11.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.11.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Ndërtimi i parkut të qytetit “ , Nr. i prokurimit- 632-22-11676-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-122-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, e dt.25.11.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i parkut të qytetit “ , Nr. i prokurimit- 632-22-11676-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-122-521, kundër NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK –së, të datës 21.11.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë 21.11.2022;**
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.**

Ar sy e t i m

Me dt.25.11.2022, Operatori Ekonomik N.SH.T. " VIKTORY COM", ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Ndërtimi i parkut të qytetit " , Nr. i prokurimit- 632-22-11676-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-122-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 29.11.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Ju keni dal mbi vlerën e parashikuar, prandaj bazuar në nenin 44, paragrafi 44.6 nën (i) të RRUOPP, pretendimi juaj është i pa bazuar:

44.6 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme:

(i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Autoriteti kontraktues nuk mund të bëj shtimin e mjeteve se dallimi midis vlerës së parashikuar dhe çmimit të ofertës juaj është shumë i madh.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës